



07-04-2023

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 02-393-2023



Në mbështetje të nenit 66.5 të Ligjit Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së, më datë 07.04.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Anulimin e Konkursit

- I. Anulohet konkursi për pozitat:
 1. KQZ- 12/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut;
 2. KQZ- 13/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Leposaviç;
 3. KQZ- 14/20223: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zubin Potok;
 4. KQZ- 15/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zveçan;
- II. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes - Divizioni për Personel për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Sekretariati i KQZ-së, më datën 30.01.2023 deri më 14.02.2023, ka shpallur konkursin për pozitat:

1. KQZ- 01/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut;
2. KQZ- 02/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Leposaviç;
3. KQZ- 03/20223: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zubin Potok;
4. KQZ- 04/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zveçan;

Ndërsa më datën 24.02.2023 deri më 13.03.2023, ka rishpallur konkursin për pozitat:

1. KQZ- 12/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut;
2. KQZ- 13/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Leposaviç;
3. KQZ- 14/20223: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zubin Potok;
4. KQZ- 15/2023: Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Zveçan;

Kryeshefi Ekzekutiv më datën 22.03.2023 ka nxjerrë vendimin Nr.02/308/2023, për formimin e Komisionit përzgjedhës për pozitat e lartcekura.

Komisioni përzgjedhës më datën 24.03.2023, i protokolluar më datën 03.04.2023, Nr. protokollit 08-364-2023, ka dorëzuar te udhëheqësi i divizionit për personel, Raportin mbi përgatitjen e listës së ngushtë, për pozitat e lartcekura, duke rekomanduar që konkursi i rishpallur të anulohet, në mungesë të kandidatëve, që nuk kanë plotësuar kushtet e parapara me konkurs.

Andaj, bazuar në Raportin e komisionit përzgjedhës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Prishtinë, 07.04.2023

Burim Ahmetaj


Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së



Ky vendim i dorëzohet:

DAP-it,

Divizionit për Personel,

Arkivit

